



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ramiz Lladrovci , Kryetar i Komunës së Glllogocit Milaim Hajdari , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Nga:	Jeton Qela , Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Datë: 08.07.2025
Zyrtarët përgjegjës:	Erblin Hetemi , Drejtor i Departamentit Ligjor	VI-020-334/7
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Komunë	Xhevat Tafa , Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit	
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Vjosa Ahmetaj , Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve Komunale	
Lënda:	Shkresë përcjellëse	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Bazuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, (shtojca II - Aktet e organeve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Kuvendit të Komunës së Glllogocit, vlerëson se:

- Vendimi 02 Nr. 020/04-24447 për plotësim ndryshimin e Vendimit 02 Nr. 020/04-19803 për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për taksa, tarifa ngarkesa dhe gjoba, i miratuar në Kuvendin e Komunës së Glllogocit, me datë 30.06.2025, nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr.020/04-24447 dt. 30/06/2025

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING		
REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministartstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration		
Data: Datum: Date:	30.06.2025	
Ngjarja organizative	Nr. i Lendës	Vlera
-01-	020-332/7	



Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit. Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 30.06.2025, miratoi këtë:

V E N D I M

Për plotësim ndryshimin e vendimit 02 Nr.020/04-19803 i datës 29.05.2025 për formimin e Komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba

Neni 1

Me këtë vendim miratohet plotësim ndryshimi i vendimit 02 Nr.020/04-19803 i datës 29.05.2025 për formimin e Komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba në nenin 1 pika 4 e tij i cili komision ka për detyrë të bëjë plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, duke e harmonizuar këtë rregullore me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, të cilin Komision e përbejnë tre (3) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilët i propozon Kryetari i Komunës, tre (3) anëtar nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme të përfaqësuar në Kuvend, dhe një (1) anëtar nga shoqëria civile komisioni në përbërje si vijon:

1. Fluida Nika - kryetare nga ekzekutivi
2. Shehrije Mustafa - anëtare nga ekzekutivi
3. Lumnije Prenku - anëtare nga ekzekutivi
4. Gani Krasniqi - anëtar nga kuvendi
5. Mërgim Pirraku - anëtar nga kuvendi
6. Egzona Tërdevci - anëtar nga kuvendi dhe
7. Arben Kuliqi - përfaqësues nga shoqëria civile, anëtar,

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi janë përgjegjëse Kuvendi Komunal, Zyra e Kryetarit dhe Drejtoritë përkatëse.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryetari i Kuvendit të Komunës
Belum Lestrani

ARSYETIM

Komuna e Drenasit përmes kërkesës së Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik ka filluar procedurat për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Komunale për Taksa Tarifa Ngarkesa dhe Gjoba si rrjedhojë e të cilit proces është edhe formimi i komisionit për hartimin e të njëjtës ku duke marrë parasysh këtë Kryetari i Komunës fillimisht përmes propozim vendimit të datës 29.05.2025 me numër të protokollit Nr. 01/020/04-19775 i propozon Kuvendit të Komunës që duke marrë parasysh legjislacionin në fuqi dhe nevojës së harmonizimit të rregullores me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës të votohet ky propozim vendim për formimin e Komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, ndërsa me vendimin 02 Nr.020/04-19803 i datës 29.05.2025 i njëjti aprovohet. Tutje përmes këtij propozim vendimi Kryetari i Komunës propozon plotësim ndryshimin e vendimit 02 Nr.020/04-19803 i datës 29.05.2025 për formimin e Komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, nenin 1 pikën 4 të tij.